



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**NGA DËGJIMI PUBLIK I KOMISIONIT PËR LEGJISLACION,
TË MBAJTUR MË 23.12. 2013**

**DHJETOR
2013**

Mbledhjen e kryeson anëtari i Komisionit për Legjislacion, zoti Armend Zemaj

KRYESUESI ARMEND ZEMAJ: Mirë dita të gjithëve,
Mirë se keni ardhur në dëgjimin publik të organizuar nga Komisioni për Legjislacion.

Grupi punues i formuar me vendim të Komisionit. Në bazë të Rregullores dhe të punës së Kuvendit për rreth praktikave të cilat Komisioni angazhohet që legjislacioni të jetë i kompletuar gjithëpërfshirës.

Sot ju kemi ftuar që ta kemi një dëgjim publik me sponsorizuesin kolegë deputetë, Agjencia Kundër Korrupsionit dhe gjithë të tjerët, shoqëria civile, organizata tjera joqeveritare dhe shumë të interesuar që janë pjesë ndonjëherë edhe të debateve këtu në komisione tona parlamentare por edhe pjesë e asaj që ne e quajmë luftimin e dukurive negative e korrupsionit në përgjithësi.

Ky projektligj hyn në fushën e Agjencisë Kundër Korrupsion. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit numër 04/L-50 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.

Si i tillë edhe ashtu është miratuar në parim në seancë plenare.

Ne kemi angazhuar edhe ekspertë që mendojmë që do të kontribuojnë në këtë fushë.

Komisioni e ka të freskët edhe miratimin e këtij projektligji nga vitet e kaluara. Po ashtu edhe gjatë raportimit të vetë Agjencisë Kundër Korrupsion. Interesimi i deputetëve dhe i komisionit ka qenë se sa po implementohet në praktikë.

Ndryshimet që janë të paraqitura mendojmë dhe për këtë arsye ju ftojmë në debat duke filluar nga Ministria e Drejtësisë. Palët tjera të interesuara dhe natyrisht edhe deputetët e Komisionit për Legjislacion të shohim se sa janë

të implementueshme, sa ... me praktikat e mira të quaj që ka të bëjë me deklarin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik.

Dhe e dyta harmonizimi me legjislacionin tjetër në fuqi siç është kodi penal dhe kodi i procedurës penale. Kjo është për ne më e rëndësishmja.

E dyta të shohim se në çfarë aspekti do të ketë implementim të këtyre ndryshimeve dhe në fund ne do të vendosim bashkërisht duke marrë parasysh që tash janë zgjeruar edhe kompetencat edhe të Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe me ligje të tjera, por edhe është zgjeruar edhe ajo që ne e quajmë mënyra e kontrollit të deklarimit të pasurisë që nënkupton edhe prejardhjen.

Ajo çka kemi pa që duhet të analizohet besoj që në mënyrën më detale, të shohim se zgjerimi i rrethit të deklarimit të pasurisë kërkon edhe me ligje të tjera siç ka të bëjë me Ligjin për trashëgiminë, kodin civil e të tjerë. dhe mendoj që këtu janë shfaq edhe disa dilema që kanë edhe nga seanca plenare, po ashtu te dispozitat ndëshkuese që ne i quajmë sepse mos deklarimi tash e tutje është edhe vepër penale që i nënshtrohet edhe kodin penal diçka që është miratuar dhe ka dal nga Komisioni për Legjislacion dhe sigurisht është mendimi i të gjithëve që ky ligj tash e ka kalua atë fazën e vetë disavjeçare, i ka kalua edhe dilemat të cilat kanë ekzistua në shoqëri dhe mendoj që tash duhet vetëm të shikohen në aspektin e implementimit dhe arritjes së sukseseve në parandalimin e asaj që ne e quajmë përfitime të pasurisë së paligjshme.

Unë po ja japë fjalën zëvendësministrit i Drejtësisë, në emër të sponzorizuesit dhe atëherë të gjithë do të kenë mundësinë që të debatojmë.

Ju kisha lutë që vërejtjet, sugjerimet të gjitha që janë që t'i dorëzohen Komisionit me shkrim, kështu që të bëhen pjesë edhe ekspertizë ligjore të angazhuar nga ekspertë dhe debati që do të vazhdojë në Komision.

Edhe një herë të ju them që do të punojmë së bashku me gjithë ata deri në fund të amendamentimit të këtij ligji dhe përcjelljes për seancë plenare. Faleminderit! Urdhëro zoti zëvendësministër.

DAUT XHEMAJLI: Faleminderit!

Përshëndetje për anëtarët e grupit,

Përshëndetje për gjithë juve të pranishëm,
Më lejoni që në emër të Ministrisë të paraqes këtë ekspozitë të shkurtër për Projektligjin ose ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-050 për deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.

Besoj që e keni parasysh që ky projektligj është i hartuar në të njëjtën kohë kur është hartuar edhe Projektligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe si rrjedhojë edhe ky pasqyron domethënë një rrjedh të ngjashme edhe një logjik të ngjashme edhe të punimit edhe të menduarit për këto ligje.

Në të njëjtën kohë pasqyron edhe qasjen e ngjashme në kuptim të gjetjes së zgjidhjeve efikase dhe kreative që të kontribuojmë arritjen e qëllimit kryesor deklarin e prejardhjes së pasurisë dhe dhuratave si dhe kontrollin e tërë.

Marrja dhe arsyet për këto plotësime ndryshime janë plotësisht të njëjta edhe ... nga të njëjtit faktorë. Prandaj, më konkretisht ky vendim që e keni ose ky propozim ndryshim që e kemi para vetes ka përmbush këto qëllime.

Që së pari të bëhet harmonizimi i legjislacionit të kësaj fushe me legjislacionin penal në fuqi, përkatësisht me Kodin Penal dhe me Kodin e Procedurës Penale sipas të cilave vepra e mosdeklarimit apo deklarimit të rren të pasurisë ka kaluar në të qenit vepër kundërvajtës tash e tutje klasifikohet si vepër penale.

Tani më zyrtari i lartë publik i cili nuk e deklaron pasurinë e tij sipas kushteve të parapara me ligj do të kryej vepër penale dhe do të përballet me sanksione shumë më të ashpra.

Sa i përket kësaj të fundit është shumë domethënë së ... se ky deklarim i pasurisë në asnjë vend të Evropës nuk klasifikohet si vepër penale përveç te ne dhe gjithsesi ky standard besoj që ne ta .. përtej atyre standardeve evropiane që ne kemi vendosur për hir të interesit të përgjithshëm publik në kuptim të kriminalizimit të kësaj veprë penale të mosdeklarimit të pasurisë.

Dhe, besoj që Agjencioni Anti-korrupsion ka pranuar deklarinimet për pasuri në përqindje të madhe gjatë vitit të kaluar mbi 99% që është një sinjal i mirë

se zyrtarët publik janë shty ose janë detyruar që të parandalojnë këtë lloj veprë.

Dhe qëllimi tjetër që lidhet me nevojën të përmbushen kërkesat e Agjencisë Kundër Korrupsion për të plotësuar dhe ndryshuar kornizën e tashme ligjore si dhe për të përmbush të gjitha rekomandimet që dalin nga raportet vlerësuese dhe monitoruese për Kosovën të Komisionit Evropian.

Të kemi parasysh se tash më shumë se dy vjet ky ligj po bëhet ose po ndryshohet në disa segmente të tij.

Vlen të theksohet se edhe këto ndryshme janë rezultat i konsultimeve të gjata që ne i kemi marrë edhe i kemi bërë edhe besoj që në këtë kuptim kontribut të posaçëm kanë dhënë Agjencioni Antikorrupsion, përfaqësues të Prokurorisë, gjykatave, Zyra e Bashkimit Evropian, EULEX-si, Ambasada Amerikane, përfaqësues të shumtë të shoqërisë civile në Kosovë dhe neve nga ana jonë jemi shumë të kënaqur me rekomandimet dhe të gjitha ato sugjerime që i kemi marrë.

Konsiderojmë që kjo është një draft me propozim ndryshime të cilësisë që neve na gëzon edhe ka vend pak për ndërhyrje eventuale.

Po ashtu jemi të kënaqur që me këtë edhe rritet efikasiteti i institucioneve tona që bëhet me këtë miratim domethënë pas miratimit të këtij projektligji.

Në anën tjetër të gjitha rekomandimet që janë marrë edhe nga raportet vlerësuese dhe monitoruese për Kosovën konsiderojmë që janë të përmbushura në këtë draft, sidomos kjo politika ose ... në kuptim të deklaratimit të pasurisë si e trajtuar si vepër penale.

Me rastin e miratimit të këtij ligji, Kosova duhet ta ketë ose do të ketë një kornizë shumë më të ... në kushtin kundër korrupsionit e cila mundëson shtyrjen e agjendës tonë të përbashkët për të parandaluar sidomos dukuritë negative të korrupsionit dhe për të luftuar sa më fuqishëm këtë dukuri.

Si pikë e parë, më lejoni të qartësoj edhe një herë edhe për publikun edhe për juve, edhe për qytetarët se të gjitha deklaratat e zyrtarëve të lartë publik do të bëhen publike dhe do të publikohen në faqen e agjencisë siç e parasheh ligji.

Në këtë pikë përkundër propozimeve të shumë akterëve që deklarimet të jenë të qashme domethënë të ketë qasje në bazë të kërkesës së palës. Kemi ardhur në përfundim që të mos ndërhyrë në këtë pjesë me që tashmë kemi vendos një standard të fuqishëm të transparencës dhe nuk dëshirojmë që të shkojmë një hapë mbrapa në këtë drejtim.

Është më se e vërtetë që standardet edhe praktikat evropiane janë në këtë pikë është referim edhe i joni, mirëpo duhet të keni parasysh se në raste të caktuara ne duhet ose jemi treguar pak më rigoroz se sa që janë këto standarde.

Për ilustrim duhet të përmendi çështjen e publikimit të deklaratave të pasurive të zyrtarëve të lartë publik ku në shumicën ose në të gjitha shtetet evropiane ekziston mundësia për t'iu qasur këtyre dokumenteve vetëm në mënyrë të kontrolluar dhe me kërkesë të arsyetuar.

Përkundër këtij trendi evropian ne kemi vendosur që publikimi i deklaratave të pasurive të vazhdoj të bëhet në të njëjtën mënyrë vetëm e vetëm që të kontribuojmë rritjen e besimit të qytetarëve dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të parimit të transparencës.

Më lejoni që në pika të shkurta duke e pasur parasysh se ju e keni para juve edhe e keni pasur këtë propozim për ndryshime të sqaroj shkurtimisht për ato ndryshime.

Duke pasur parasysh se të gjitha këto ndryshime janë në harmoni me Kodin Penal edhe Kodin veçanërisht të Procedurës Penale në Kosovë.

Edhe në këtë projektligj kemi paraparë dispozita të reja që e obligojnë Agjencinë Antikorrupsion të paraqes kallëzim penal pranë prokurorisë për rastet kur ka fakte të mjaftueshme se është kryer vepër penale nga personi i cili ka qenë i obliguar të deklaroj dhe nuk e ka deklaruar ose e ka deklaruar pjesërisht pasurinë e tij.

Kemi shtuar numrin e personave që e përmendi edhe kryesuesi, që janë të obliguar të deklarojnë me ligj pasurinë për shembull e keni te kryetari i Komisionit Qendrorë, anëtarët e Komisionit Qendrorë Zgjedhor, të gjithë të

emëruarit e presidentit, anëtarët e Këshillit Drejtues të Universitetit e tjera e tjera.

Për një transparencë më të madhe dhe më të qëllimshme të këtij ligji kemi zgjeruar ... e anëtarëve të familjes që është harmonizuar me përkufizimin e njëjtë si është në Kodin Penal dhe në këtë mënyrë është zgjeruar fushëveprimi i këtij ligji. Në të njëjtën kohë janë përfshirë edhe zyrtarë të lartë tjerë publikë, me qëllim të zgjerimit të rrethit të zyrtarëve të lartë, që duhet të deklarojnë pasurinë.

Një risi tjetër që vlen të përmendet, është fakti që me ligjin e tanishëm duhet të lajmërohet çdo pasuri e lujtshme mbi vlerë 5 mijë euro, ndërsa me ndryshime të reja që pritet të hyjnë në fuqi, ose që janë propozuar, personat që bien në fushëveprim të këtij ligji janë të obliguar të deklarojnë çdo pasuri që është mbi 3 mijë euro vlerë.

Sikurse edhe tek projektligji tjetër, kemi specifikuar dhe qartësuar dispozitat e tashme dhe ato të cilat Agjencisë Antikorrupsion i kanë shkaktuar probleme deri tash gjatë zbatimit në praktikë të këtij ligji dhe kemi shtuar dispozita të qarta ligjore, përmes të cilave agjencia ka më shumë kompetenca dhe është e obliguar që të jetë më proaktive në kryerjen e detyrave të saj.

Më rastin e inkorporimit të këtyre risive në sistemin e kornizës së përgjithshme kundër korrupsion, besojmë me këtë Kosova do të sofistikojë këtë pjesë të legjislacionit dhe do të krijojë kushte më të volitshme, për të parandaluar korrupsionin dhe për ta luftuar atë në rastin më të keq.

Dispozitat ligjore obligojnë Agjencinë Antikorrupsion, prokuritë dhe gjykatat e Kosovës, që të parandalojnë, ndjekin, përkatësisht të gjykojnë personat që nuk e deklarojnë pasurinë, apo e deklarojnë atë në mënyrë të rrejshme apo të pjesshme. Ne presim që ky obligim të kthehet në rezultate konkrete në rastet kur do të paraqitet nevoja, mirëpo qëllim primar i këtij projektligji ka qenë dhe është që të parandalohet mosdeklarimi dhe këtë gjë besoj që do ta arrijmë, sikurse kemi pasur rastin që gjatë vitit 2013 mbi 99% të zyrtarëve kanë deklaruar pasurinë e tyre.

Besojmë që ky propozim-ndryshim i këtij projektligji do të ketë efekte pozitive, pasi që rritja e sanksioneve për veprat e përmendura do të rrisë

edhe zbatimin efektiv të këtij ligji dhe besojmë që do të ketë rol edhe në rritjen e nivelit të besimit edhe të sigurisë së qytetarëve të sistemi jonë.

Unë i kam parasysh të gjitha këto që janë bërë si propozim-ndryshime dhe besoj që të gjitha ato, që eventualisht do të merren si propozime, i kemi në konsideratë në të ardhmen. Ju faleminderit!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti zëvendësministër! Dikush tjetër prej kolegëve... Urdhëro Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit shumë! Ju përsëndes të gjithëve! Sa i përket këtij projektligji, sikur edhe ai për parandalimin e konfliktit të interesit, unë mendoj që vërejtjet e parapara janë teknike, jo shumë përmbajtjesore. Kisha dashur të përmend këtu fillimisht faktin që në kohën kur projektligji ose projekt-kodi penal na është sjellë në Kuvend, deklarimi i pasurisë ose mosdeklarimi i pasurisë nuk kanë qenë të parapara në atë draft-kod, mirëpo janë futur si amendamente nga Komisioni për Legjislacion në bashkëpunim me shoqërinë civile. Pra, nuk ka qenë kjo që është bërë nga Ministria e Drejtësisë.

Sa i përket publikimit ose deklarimit të pasurisë, ju e përmendët faktin që anëtarët e KQZ-së dhe kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve tashmë me këtë projektligj obligohen, që të deklarojnë pasurinë e tyre, mirëpo ata tashmë e kanë bërë deklarimin edhe viteve të kaluara. E kemi këtu përfaqësuesin e Agjencisë Kundër Korrupsionit, ekziston pra pasuria e tyre në ueb-faqen e agjencisë, kështu që unë nuk e di se kjo konsiderohet si e avancuar.

Në memorandumin shpjegues të këtij projektligji, mirëpo edhe në fjalët e juaja edhe ato të ministrit në kohën kur u miratua ky projektligj në Kuvend, po thuhet që me këtë projektligj do të avancohet pakoja kundër korrupsionit, mirëpo unë mendoj që pakoja kundër korrupsionit nuk bëhet me plotësime të tilla. Mirëpo, kur Kuvendi miraton Ligjin antimafia, Ligjin kundër korrupsionit dhe Ligjin për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme, e që ne si subjekt politik tashmë e kemi proceduar në Kuvend këtë të fundit dhe shpresojmë që do të kemi mbështetje edhe nga subjektet tjera.

Ne jemi dëshmitarë të asaj që këtyre viteve të fundit në vazhdimësi është duke u rritur pasuria e zyrtarëve të lartë dhe atë në mënyrë enorme, prejardhja e së cilës assesi nuk mund të hetohet. Unë mendoj, që është e obligueshme, që për çdo cent që marrin zyrtarët e lartë, ajo të deklarohet në Agjencinë Kundër Korrupsionit e që ky projektligj nuk e parasheh një gjë të tillë.

Unë mendoj që në këtë mënyrë nuk ndërtohet shteti i së drejtës. Për mua është e papranueshme që abuzuesit me pasurinë e popullit të vihen në themelin e shtetit tonë, sepse një shoqëri e lirë dhe demokratike nuk mund të ekzistojë pa drejtësinë shoqërore.

Sa i përket projektligjit në fjalë në nenin 6 thuhet, se dhuratat e rastit konsiderohen dhurata të vogla me vlerë deri në 25 euro dhe se zyrtari i lartë nuk mund të pranojë dhurata të rastit, vlera e së cilave kalon mbi 500 euro. Unë mendoj që askush nga ne nuk mund të dijë vlerën e një dhurate. Është shumë e vështirë për zyrtarin, që ta dijë... për shembull, për mua ky stilolaps bën 50 euro, për dikë tjetër bën 2 euro, për dikë tjetër 25 euro... tash, nuk mund ta dimë vlerën e saktë ne. Kështu që është obligative, që për secilën dhuratë që marrin zyrtarët e lartë, ta paraqesin atë pranë Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Këtë shqetësim e kam ngritur edhe në projektligjin, kur na ka ardhur fillimisht vitin e kaluar për ndryshim.

Në paragrafin 6, neni 7, thuhet që Agjencia Kundër Korrupsionit ka detyrim ligjor për mbajtjen e regjistrave deri në 10 vjet, por nuk qartësohet se çka bëhet pas 10 vjetëve, çka bëhet me atë regjistër të dhuratave të zyrtarëve të lartë. Pra, nuk ka asnjë specifikim të kësaj çështjeje.

Unë po shprehë shqetësimin tim përsëri për mungesën e bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe grupet e interesit ose institucionet, në këtë rast Agjencinë Kundër Korrupsionit, sepse edhe në këtë rast ju nuk i keni marrë parasysh vërejtjet shumë përmbajtjesore të tyre. Po e ngre disa herë, që këto takime me grupet punuese, që po bëhen nga Ministria e Drejtësisë po bëhen vetëm sa për sy e faqe, pra duke mos i marrë parasysh fare vërejtjet e agjencisë, në këtë rast kundër korrupsionit e që janë gjashtë prej tyre, të cilat tashmë neve na u drejtuan këtu.

Pra, ne si Komision për Legjislacion e kemi shumë të vështirë të prekim ligjin aktual, sepse ajo duhet të konsiderohet një nismë e re legislative dhe nuk mund të bëjmë asgjë në këtë fazë. Kështu që, po na e vështirësoni edhe neve punën, duke mos i marrë parasysh vërejtjet e tyre. Unë kaq kam për tash. Shpresoj të kyçem prapë.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, Albulena.

Të ftuar kanë qenë edhe shoqëria civile dhe bash më erdhi çudi fakti, se edhe si deputetë edhe si komision, në njëfarë forme atakohemi jo rrallëherë për transparencën, por ky është dëgjim publik dhe është rasti më i mirë, që të gjithë t'i shprehim mendimet, sa i përket këtij projektligji dhe pikërisht kësaj fushe, e cila shpeshherë është senzibile dhe është e lezetshme edhe për opinionin dhe për mediat dhe për shoqërinë civile. Kështu që, është vërejtje parimore edhe imja, që herëve të tjera kur t'i ftojmë në dëgjime publike le të marrin pjesë vërejtje dhe sugjerime të gjitha ato, ashtu siç ka punuar komisioni, sidomos ky komision, tash pa dashur me qenë subjektiv në raport me komisionet tjera, është mirë me qenë pjesë sepse edhe në të ardhmen po kemi telashe në harmonizim të qëndrimeve ose eventualisht ndonjë propozim që është i kapshëm dhe i mirë edhe për neve. Kështu që vazhdojmë, urdhëroni kush e dëshiron fjalën? Agjencia Kundër Korrupsion, urdhëroni!

MILOT KRASNIQI – AKK: Përshëndetje!

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

I nderuar zëvendësministër,

Të nderuar pjesëmarrës të tjerë në këtë dëgjim publik,

Unë jam Milot Krasniqi, këshilltar ligjor në Agjencinë Kundër Korrupsionit.

Do të mundohem që në pika të shkurta të paraqes një referat në lidhje me plotësim ndryshimin e projektligjit për deklarimin e pasurisë dhe dhuratave.

Siç e dini, arsyeja kryesore e rishikimit të këtij projektligji ka qenë afektimi i zgjidhjeve që janë dhënë në Kodin Penal, përkatësisht kur në Kodin Penal është paraparë që mosdeklarimi i pasurisë dhe dhuratave dhe detyrimeve financiare është bërë vepër penale, sepse më herët, në bazë të ligjit që është në fuqi, për deklarimin e pasurisë dhe dhuratave, kjo vepër ka qenë e kategorizuar si kundërvajtje.

Agjencia Kundër Korrupsionit në vazhdimësi ka dhënë kontributin e saj. Ajo ka bërë edhe propozimin që të rishikohet ky ligj dhe të harmonizohet me Kodin Penal. Në disa takime dhe grupe punuese, që janë organizuar nga sponsorizuesi i këtij ligji, që është ministria e drejtësisë, ne kemi marrë pjesë aktivisht me vërejtje, propozime e sugjerime, me qëllimin më të mirë të mundshëm, që të hartohet një ligj konkret, praktik dhe të shmangen të gjitha të metat, që janë evidentuar gjatë punës sonë, gjatë zbatimit në praktikë të dispozitave të këtij ligji.

Disa vërejtje tona, konsideroj se nuk janë marrë parasysh. Ne i kemi qitë edhe me shkrim dhe të njëjtat ia kemi adresuar Kuvendit, përkatësisht Komisionit për Legjislacion dhe administratës së Kuvendit. Unë do të isha ndalë në dy pika kryesore, që mendoj se do të duhej të rishikoheshin e këto pika kanë të bëjnë së pari me emërtimin e vet projektligjit.

Në emërtimin e projektligjit është futur edhe çështja e prejardhjes së pasurisë, ndërkaq po t'i bëhet një kontroll detaj i dispozitave të këtij ligji dhe projektligjit aktual, që është para nesh, nuk ka asnjë dispozitë që rregullon çështjen e prejardhjes së pasurisë.

Në këtë rast konsideroj se duhet vepruar në dy mënyra: ose të rregullohet çështja e prejardhjes së pasurisë me dispozita përkatëse; ose si i tillë, nëse nuk parashihet asgjë, të largohet fjala për prejardhje, sepse faktikisht emërtimi nuk po përputhet me përmbajtjen reale që ka ligji.

Çështja e dytë është, se ne kemi propozuar që për ushtruesit e detyrave, të cilët qëndrojnë më gjatë se tre muaj në këtë pozitë, do të thotë të obligohen që ta deklarojnë pasurinë. Disa të tjerë kanë pasur edhe mendime të ndryshme rreth kësaj pike, mirëpo ne konsiderojmë se është me rëndësi, sepse ushtruesit e detyrave i kryejnë të gjitha detyrat, i kanë edhe të drejtat edhe detyrimet të personit, pozitën e të cilit e ushtrojnë.

Supozojmë, një ministër ose një sekretar po të shkarkohet ose po t'i përfundojë para periudhës mandati, ushtruesi i detyrës në pozitë të tij i merr të gjitha të drejtat dhe obligimet e tij. Ai mund të nënshkruajë kontrata, mund të kryejë shërbime, mund ta përfaqësojë institucionin, e tjerë.

Andaj, ne kemi propozuar që çdo pozitë në këtë nivel, do të thotë të obligohen që ta deklarojnë pasurinë dhe ky afat rrjedhë menjëherë pas tre

muajve dhe të jetë në kohëzgjatje prej 30 ditësh. Kjo është kohë e mjaftueshme për ata, mund t'i përgjigjen këtij obligimi ligjor.

Edhe pse e them me bindje të plotë, se dispozitat e këtij ligji janë zbatuar në masën më të madhe të mundshme nga agjencia në çdo rast konkret, megjithatë një vërejtje e kemi pasur me pikat e kontaktit, me zyrtarët kontaktues, sepse ne nuk mund të lidhim dhe krijojmë dhe mbajmë kontakte me secilin person që ka për obligim deklarin e pasurisë. Ligji aktual që është në fuqi parasheh që agjencia kontaktet e saj me personat që kanë për obligim deklarin e pasurisë dhe dhuratave, të bëhet nëpërmjet zyrtarëve përkatës të institucionit, që shërbejnë si pikë kontakti me ne.

Këta persona kanë për obligim, që t'i njoftojnë zyrtarët e lartë publikë me obligimin për deklarin e pasurisë dhe dhuratave, për afatin se kur duhet të deklarohet, e tjerë.

Në praktikë ka ndodhur, që pikat e kontaktit të mos e kryejnë detyrën me rregull dhe për këtë në çdo rast janë iniciuar procedura ligjore. Ne nuk jemi që ata të ndëshkohen, mirëpo do të duhej të gjendej një zgjidhje, që të jenë më azhur në detyrën e tyre, që mos të pësojnë as personat që kanë për deklarin e pasurisë, si pasojë e mosnjoftimit me kohë.

Nga ana tjetër, secili duhet ta dijë obligimin që ka për deklarin të pasurisë, sepse është parim i përgjithshëm i drejtësisë, që mosnjohja e ligjit nuk e arsyeton askënd. Megjithatë, po të mundemi që ta shtojmë azhuritetin e pikave kontaktuese do të ishte mirë dhe do të ishte një lehtësim i punës edhe për ne edhe për ta dhe për institucionet që i caktojnë këto detyra.

Një çështje tjetër, ne konsiderojmë se në asnjë rast zyrtarët, të cilët i nënshtrohen këtij ligji, nuk duhet të pranojnë dhurata mbi vlerën e lejuar, që ishte edhe diskutabile, siç e përmendi deputetja, mirëpo në rastin kur kalohet dhe ndoshta për arsye objektive ose subjektive nuk e ka ditur se ka tejkaluar vlerën e paraparë me ligj, kemi propozuar që kjo dhuratë të mbetet pronë e institucionet dhe jo e personit, sepse është në të mirë të opinionit publik.

Një pikë tjetër kontestuese për neve edhe që është e papranueshme edhe e panevojshme ndoshta ka qenë zgjidhja e paraparë në nenin 16 të

Projektligjit. Ku është paraparë se agjencia të angazhojë ekspertë për vlerësimin e vlerës së pasurisë së deklaruar, dhuratave etj.

Kjo çështje është shumë ndoshta edhe subjektive për mua siç e përmendi edhe deputetja, po e citoj, për mua një kimik ose një pasuri mund të ketë një vlerë të caktuar, në treg mund të ketë vlerë tjetër, mirëpo për ty ose për tjetrin person mund të ketë prapë një gjykim tjetër se sa është vlera e tij.

Andaj, ajo që është e rëndësishme ne kemi konsideruar që është e rëndësishme që të deklarohet pasurie, në këto raste vlera që i jepet pasurisë është ose vlera e tregut ose sipas vlerësimit që i bën vetë personi që e deklaron. Pastaj, çështja e angazhimit të ekspertëve kërkon edhe mjete buxhetore. Ne kemi një buxhet të kufizuar, nuk di sa na lejon tash. Pastaj, kemi konsideruar se është si zgjidhje e panevojshme dhe si e tillë duhet të fshihet, do të thotë ky paragrafë i paraparë në nenin 16 të Projektligjit.

Çështja e qasjes në informata. Ne gjatë punës tonë në praktikë për qëllime zyrtare, do të thotë kemi kërkuar informacione nga subjektet të cilat disponojnë me të dhëna afariste siç janë bankat dhe institucionet financiare për nevojat zyrtare të agjencisë. Mirëpo, në nenin 16 të Projektligjit, paragrafin 3 është paraparë që kërkesat tona, të cilat ju adresohen për të pasur këto të dhëna, për t'i vërtetuar do të thotë lëvizjet e pasurisë së zyrtarëve publik të shkojë në pajtim me Kodin e procedurës penale.

Kjo në aspektin juridik është mirë, mirëpo në praktikë neve na shkakton probleme, sepse po të shkojnë kërkesat tona për qasjen në informata, atëherë ekziston rreziku potencial që këto kërkesa të prolongohen, të shtyhen, të mos shqyrtohen ose të mos na jepen fare dhe kështu rastet të mbeten të pa trajtuara dhe nuk kemi mundësi t'i verifikojmë lëvizjet që pësojnë pasuria e zyrtarëve të lartë publik.

Andaj, kemi munduar që fjalën në pajtim me Kodin e Procedurës Penale të largohen dhe të jetë sikurse që është aktualisht në Ligjin aktual, do të thotë me kërkesat të cilën e nënshkruan drejtori i agjencisë, i dërgohet institucionit përkatës ai në afatin e paraparë i dërgon informatat kthyesë dhe të mos shkojë nëpërmjet prokurorit dhe Kodit të Procedurës Penale, sepse ekziston rreziku i mos marrjes tyre informatave fare.

Një çështje tjetër, është do të thotë çështja e publikimit të emrave të zyrtarëve të lartë publik, të cilët nuk e deklarojnë pasurinë dhe dhuratat. Në nenin 17, paragrafi ... Projektligjit është i nevojshëm do të thotë që të riformulohet, po ashtu pasuria dhe dhuratat edhe pse janë çështje të ndërlidhura në praktikë janë faktikisht çështje të ndara, veç është pasuria, veç janë dhuratat.

Kësisoj, paragrafi 3 i këtij neni do të duhej të ishte që të përfshihet do të thotë një paragraf i cili do të ndante obligimin e deklarimit veç të pasurisë, veç të dhuratave, si dhe agjencia t'i publikojë me regjistra përkatës të ndarë, do të thotë edhe pasurinë edhe dhuratat dhe jo në një vend.

Kjo ishte pak a shumë në pika të shkurtra, mendojmë se nëse përfshihen këto vërejte sado që mund të duken ndoshta teknike, mirëpo ne i kemi vërejtur gjatë punës tonë në praktikë mendojmë që projektligji do të avancohej dukshëm. Sigurisht nuk mund të bëhet një ligj perfekt, sepse kjo është ndoshta e pamundur, mirëpo në masë të madhe do ta përmirësonte punën tonë. Faleminderit!

BEHAR SELIMI: Faleminderit, shumë!

... atëherë edhe njëherë kryetari pat një detyrim tjetër, kërkoi prej meje që të vazhdoj me diskutimet. Unë insistova mos me i dal profesor Bajramit përpara, por jam edhe nënkryetar i komisionit dhe procedura e kërkon aspektin formal që unë ta drejtoj.

Prandaj, ne po vazhdojmë. Dikush tjetër? Faleminderit, për mënyrën se si e prezantove. Dikush tjetër? Po.

ALBULENA HAXHIU: Shumë shkurt. Sa i përket çështjes së angazhimit të ekspertëve edhe unë e pash si problem për shkak se e dimë tash procedurat ose praktikrat qysh kanë rrjedh në angazhimin e ekspertëve, a janë të pavarur apo të varur, a ndikohen nga politike edhe këtu nuk ka asnjë qartësim të kësaj dispozite. Mendoj që nuk duhet të lihet në asnjë mënyrë kështu, as nuk përcaktohet afati a zgjidhen ata ekspertë për çdo vit me konkurs.

Kjo është diçka e vështirë edhe për Agjencionin Kundër Korrupsionit në rast të vlerësimit të pasurive, mandej thotë “vlerësimit të pasurive ose

çështjeve tjera që kanë të bëjnë me aktivitetet tjera të agjencisë” më duket që kjo vetëm sa do ta vështirësoj punën e vështirësuar të Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe nuk do t’i shërbejë pra luftës kundër korrupsionit ose vlerësimit të pasurive të zyrtarëve të lartë. Kaq mendoj.

KRYESUESI: Faleminderit!
Dikush tjetër? Po, urdhëro...

DAUT XHEMAJLI: Unë ju përshëndes, faleminderit për komente. Për këtë terrenit politik nuk dua me hy mua më intereson domethënë propozimet eventuale, konkrete që bëhen eventualisht për ndonjë formulim tjetër apo ndonjë propozim konkret.

Unë dëgjova këtë përfaqësuesin e këshilltarin ligjor të Agjencisë, emërtimi nuk e di sa ka mundësi me u ndryshu, domethënë i këtij projektligji, por ne i kemi pas parasysh domethënë këtë punën e zyrtarëve që ushtrojnë ushtrues detyre që janë, janë të futura në ligj. Personi kontaktues i secilit institucion është i futur këtu, domethënë është i ... si person.

Tjetër është me vendim që nuk është thënë diku ndoshta mundet me u precizu që përgjegjësi i institucionit ka obligim ligjor me vendim me e caktu një person, dhe të cakton po .. ndoshta nënkuptohet ajo.

Edhe çështja është se ekspertët që angazhohen te agjencia thotë “mund të përzgjedh” në rast se agjencisë i nevojitet. Domethënë ndonjë ekspertë për me e caktu atë. Mundet edhe nuk besoj që është ndonjë problematik se këto e sqaron se ata ekspertë, domethënë duhet me u zgjedh me konkurs, se duhet me u ditë. Agjencia duhet me pas një rregullore për këtë punë që i cakton kriteret e saj edhe fushën e veprimtarisë tyre.

Në këtë aspekt unë mendoj që nuk është obligim i ligjit me saktësu punën e ekspertëve në agjencinë anti korrupsion. Tjetra është që këta ekspertë që s’i paguhen domethënë a ka buxhet agjencia a jo. Agjencia pas mbledhjes së këtij ligji duhet të mendojë edhe për propozimin e vetë buxhetit që duhet ta ketë në të ardhmen eventualisht për kompensimin e punës së tyre.

Ne në këtë ligj nuk mundemi me thënë qysh do të kompensohen edhe ku do të jetë ai buxhet.

(Ndërhyrje)

Te ne jo, domethënë...

(Ndërhyrje)

Por, agjencia me vetë faktin që shpall ose angazhon ekspertë nënkuptohet që buxheti është i agjencisë. E tash sa është ai buxhet na sa të kemi buxhet harxhojmë, por megjithatë domethënë sa ka mundësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zëvendësministër!

Po prof, urdhëroni!

ARSIM BAJRAMI: E vlerësoj pozitivisht këtë amandamentim të ligjit plotësim edhe ndryshim.

Do të ndalem vetëm në çështje që ... edhe përfaqësuesin e Agjencisë Kundër Korrupsionit, por edhe ministrin ta diskutojmë këtë punën e vlerës formale dhe vlerës reale të pasurisë së deklaruar, aty janë probleme. Sepse, është edhe një fushë pak edhe manipulative aty nëse e deklarojnë pasurinë, nuk e kam problemin e pasurisë e cila shkon përmes sistemit bankar, pasurisë monetare të holla, e kom problem sa i përket vlerës reale të pasurisë së paluajtshme, sepse nëse i merrni tash formularët nga i njëjti person të vitit 2001, 2004 shihni lëvizje marramendëse.

Ajo është pjesë manipulative ku për shembull në vitin 2001 një mal vlen 100 mijë euro, në vitin 2012 një mal vlen ... a kemi mundësi që aty diçka me bë në ligj. Agjencia vetë apo me bë detyrim ligjor që me ekzistojnë një mekanizëm, një kontroll ju e keni parë për shembull brenda Parlamentit ka lëvizje të vlerës pasurore të deputetëve apo diçka tjetër edhe ajo nuk shprehet shumë në para të gatshme, sepse është shumë lehtë për të zbuluar pasurinë e paligjshme sa i përket parave. Çdo para që nuk ka shku përmes sistemit bankier dhe që nuk mbulohet me një qarkullim ligjor që bëhet është e dyshimtë edhe mund të hetohet, por mbulimi i pasurimit të pabazë bëhet kryesisht përmes pasurisë së luajtshme.

A mundemi diçka me bë në qat drejtim, unë e pash problemet që kemi me ekspertë të agjencisë, unë kisha kërkuar prej agjencisë që ai me i zhvillo mekanizmat të brendshëm. Neve na qet kaniher në dilemë kur e mbushim sa

na kushton shpija, apo diçka na gjithmonë pyesim kaniher agjencinë e me shkru vlerën investuese apo me shkru vlerën reale para ... sepse vlera reale nuk mund nga pronari ai bëhet nga një ekspertizë profesionale, nga një agjenci e specializuar. ... me pas depërtu me vendos një kontroll ndaj pasurisë së paluajtshme, ndaj tokave, shtëpive, gjërave tjera.

Do të ishte një kontribut i madh në luftimin e korrupsionit edhe transparencës së lëvizjes së pasurisë edhe do të ishte një përparim i madh i agjencisë. Agjencia mos bëhet një servis i thjeshtë që vetëm i ... faktet, por të bëhet edhe një mekanizëm që fiton pak prejardhjen e pasurisë, origjinën e pasurisë. Me mujt qaty me e bë një dispozitë në kuadër të këtij amandamentimi, obligative kishte me qenë një sukses i madh në kompletimin e kornizës ligjore në luftimin e korrupsionit, sepse unë vlerësoj se ky projektligj dhe projektligji për evitimin e konfliktit të interesit janë përsosje e më tepër e paketës ligjore në luftë kundër e korrupsionit.

Ndoshta, më së miri këtë përgjigje kishte me dhënë Agjencia Kundër Korrupsionit që i din këto probleme, ka bë këto analiza dhe kishte mujt me e i bë kategoritë ligjore në mënyrë që në këtë fushë të vendoset një kontroll publik ndaj pasurisë së zyrtarëve që i nënshtrohen deklarimit të pasurisë.

KRYESUESI: Faleminderit, prof! Zoti Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit! Dy ose tri fjalë. Kjo që e tha profesori tashmë është diçka që na ka ndodh në të kaluarën është ndryshuar ligji gati me, kur është ndryshuar herën e parë gati me insistim timin për shkak se kemi pas problem me deklarim të pronës edhe me përsëritje të pronave.

Edhe ideja ka qenë që nëse një pronë e paluajtshme deklarohet e njëjta vit pas viti, atëherë problemi është më i vogël se sa nëse deklarohet diçka tjetër. Te vlerësimi e tha edhe profesori është e vërtetë tjetër kund ka agjenci të specializuar e cila bën vlerësimin e pronës, domethënë e përcaktojnë vlerën e përafërt të pronës edhe e lëshojnë një certifikatë në bazë të cilës vlerësohet ajo pronë.

Te na jo, e vërtetë është se na ka ndodh secilit na ka ndodh ma për pronën e njëjtë kam harruar sa kam deklaruar se herën e kaluar jam kan i disponuar kam mendu që vlen shumë, herën tjetër pak ma i pa disponuar domethënë s'vlen gjë ajo hiq edhe domethënë ndodh kjo.

Po, problemi është i vogël nëse e njëjta pronë deklarohet pa ndryshime, ose të tokës. Tani problemi rritet nëse dikush e deklaron një pronë si shtëpi edhe ajo shtëpi është e vjetër, e pa meremetuar edhe ndërkohë bën një investim disa qindra, mijëra euro në atë shtëpi edhe prapë e deklaron të njëjtën. Domethënë këtu na paraqitet problem real se mundet mjete të mëdha materiale me u investu në të njëjtën pronë edhe prapëseprapë si emërtim me figuru njëjtë shtëpinë shembull po e marrim.

Kështu që neve na duhet me gjet zgjidhjen këtë temë, unë po e shoh që është goxha problem me gjet zgjidhje përderisa nuk kemi me pas agjenci të certifikuar, domethënë me pas njëfarë ligji të veçantë për këtë punë në mënyrë që me i shfrytëzu ato agjenci.

Nëse ne provojmë vetë me bë vlerësimin e pronave, atëherë hyjmë një rrugë e cila është goxha problematike se na nuk jemi as të thirrur as nuk jemi kompetentë me bë gjëra të tilla, kthehet në spekulim total.

Dikush mendon që është më shtrenjtë, dikush më lirë edhe na bëhet problem politik vlere e një prone të cilën ne nuk duhet me pas ashtu. Domethënë, ideja është që me provu me pa si e kanë rregulluar vendet tjera këtë çështje të vlerësimit të pronave edhe ndoshta edhe ne me e nisë. E di që nuk bëhet menjëherë, e di që merr kohë por diçka duhet me nisë.

Çështja tjetër për të cilën kisha dashur me fol e që nuk është ndoshta shumë ndihmesë për punën që po bëjmë, por s'po muj pa thënë ndërlidhet me shumë ligje. Ne kemi shumë iniciativa për me i ndryshu ligjet. Shihni, sivjet kemi pas numër dyshifror të madh të ndryshimit të ligjeve. Mendimi im si një njeri që është në Kuvend dhe në institucione për një kohë kogja të gjatë thash, është se këto nisma po vijnë prej departamenteve ose institucioneve të cilat kanë mbetur pa bë kurrgjë dhe po u bie ndërmend me e ndryshuar një ligj se po ju duket se është keq edhe po shtinë krejt mekanizmin shtetëror me u marrë dhe me u stërmarrë me ato ligje pa pasur studim pse po ndërrohet ligji, janë diku dy ose tri taste kur një institucion ose shteti vendos me e ndryshuar ligjin.

Rasti i parë është kur e sheh që nuk po funksionon dhe ky është rasti më i zorshmi, nëse e sheh që një ligj nuk po funksionon, nuk po implementohet, atëherë duhen analiza tepër serioze pse nuk po implementohet dhe çkja

bënë, a e bënë ligjin më fleksibil, a e shtrëngon më tepër apo çka bënë apo e heq krejt. Rasati i dytë është kur ligji funksionon perfekt edhe shteti ka vendosur me e rritë standardin në atë fushë. Për shembull po e marrim, nëse ky ligj deri tash ka funksionuar prefekt, na dom që deklaratat, dhuratat me qenë edhe më të vogla se sa që kanë qenë, mendoj me e shtrënguar sistemin, atëherë është më kollaj, është shumë më kollaj por në këto raste, raste me të cilat na jemi tu u ballafaquar një kohë tepër të gjatë, nuk e kanë as arsyetimin e parë as arsyetimin e dytë. Nuk e dimë pse, deklarativisht po, në deklaratë thuhet po unë po domë me e ndryshuar ligjin dhe me bë një ligji më të mirë, pse? Për shkak se është implementuar krejt dhe domi me e avancuar sistemin edhe pak më tutje apo për shkak se nuk po funksionon ligji hiq. Po më duket që në këtë legjislaturë ne nuk jemi të gatshëm ose nuk jemi të përgatitur me u marrë me këtë temë. Unë këtë e thash për transkript që dikush në të ardhmen duhet me filluar me menduar lidhur me këtë temë, nuk bënë me i lodhë Kuvendin dhe institucionet veç pse, më falni në shprehje nuk ka të bëjë drejtpërdrejtë me këtë ligj do me thënë mos ta merr dikush si problematike, ka të bëjë me fenomenin, nuk bënë me i lodhë institucionet me tema me na shti në sistem, me punuar me u lodhë përderisa kemi punë tepër të rëndësishme të cilat i kalojmë shpejtë e shpejtë.

Ma merr mendja që, edhe një herë po them dhe kjo nuk është shumë ndihmesë çka po them, kjo legjislaturë nuk është e gatshme me u marrë me këtë problem të vetin, unë po them për transkript, legjislaturat e ardhshme duhet me qenë të gatshme, me u marrë me këtë temë kur ta bëjnë strategjinë legjislative, në atë strategji legjislative, çdo institucion që ka me propozuar projektligj, ka me provuar me sponsorizuar diçka, duhet me shpjeguar tepër gjatë pse po e bënë këto. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Urdhëro prof.

ARSIM BAJRAMI: Nuk është replikë. Kjo çka po shtron deputeti Gjini është një fenomen, neve po na pengon në aktivitet legjislativ, do të thotë fakti që neve 2/3 e ligjeve na vinë në renovim çdo vit me plotësim dhe ndryshim, tregon diçka që ne duhet ta diskutojmë. Jemi tani duke e përgatitur edhe Ligjin për aktet normative, mungesa e studimit të fizibilitetit për ligjet nga sponzorusit. Para se me ardhë në Kuvend, do me thënë Qeveria nuk ka studime të mira të fizibilitetit të qëllimeve që dëshiron me arritur ligji. Çka na ndodhë? Ta lënë ligjin dhe brenda vitit një herë, dy

herë, tri herë apo brenda le të na vjen në ripërpunim, nuk është problemi këtu i Parlamentit, sepse fizibilitetin e qëllimeve të Ligjit duhet me e bë sponzorisi edhe në momentin kur ligji po zbatohet, po e merr Qeveria anë zbatim ose po ua jap agjencive ekzekutive në zbatim, menjëherë po vërehen parregullsintë. Edhe tash ky ligj që po plotësohet dhe po ndryshohet, është pikërisht sepse nuk ka ekzistuar një studim kureshtar ligji bazik, kur ka ardhur ligji bazik nuk janë parë situatat ose janë paraparë problemet gjatë veprimit praktik. Kështu që arsyeja pse ne po shpenzojmë 2/3 e kohës në parlament me plotësim dhe ndryshim të ligjeve, është pikërisht që kjo e metë ekziston në fazën para se ligji të vjen për herë të parë në Parlament.

Nuk po studiohen të gjitha segmentet e implementimit të Ligjit dhe ky është një problem që po bënë që praktikisht të mos e kemi një sistem juridik stabil apo gjithmonë, çdo vit të merremi me plotësime dhe ndryshime të ligjeve. Unë po shpresoj se tani me këtë ligj, ne do ta përpunojmë këtë çështje për aktet normative dhe procesi i nxjerrjes së ligjeve, duhet të përcillet edhe me studimin paraprak jo vetëm me 2-3 faqe shpjegim të arsyetimit të ligjit që na vjen në formë të shabllonit, por të ketë një studim efektet, qëllimet dhe dimensionet që dëshiron me i arritur.

KRYESUESI: Faleminderit prof! Urdhëro!|

FRASHËR MURTEZAJ, Udhëheqës i Divizionit në Agjencinë Kundër korrupsionit.

Desha të ndalem te pyetja që e ngriti profesori: deklarimi vullnetar apo sipas dëshirës e pasurisë tek zyrtarët. Na gjatë zbatimit të ligjit kemi pasur dhe kemi kërkesën prej zyrtarëve të lartë publik që në moment kur vinë ta mbushin formularin për deklarimin e pasurisë, pyetja e parë që bëhet është: si ta bëjë vlerësimin e një kapitali të caktuar. Edhe gjatë hartimit të këtij ligji, na gjatë takimeve me Ministrinë e Drejtësisë e kemi ngritur si çështje për shkakun se është një problematikë më e zgjeruar se sa që është e paraparë në vet ligjin aktual. Shumica e vendeve që kanë në zbatim në ligj të tillë për deklarim të pasurisë, zakonisht vlerësimin e kapitaleve apo asetëve, shumica prej këtyre vendeve e kanë si institucion që bëjnë vlerësimin, janë institucione shtetërore mirëpo ka edhe agjenci të specializuara që e bëjnë një gjë të tillë.

Te ne në Kosovë mungon ajo, sepse Kosova si shtet i ri nuk ka qasje në shumë institucione që duhet të ketë një shteti i pavarur siç është Berza,

Banka Botërore dhe shumë institucione tjera që janë të specializuara për një problematikë të tillë.

Gjatë komisioneve për hartim të këtij projekt buxheti, ne ju kemi drejtuar edhe Ministrisë të Drejtësisë që ta precizojnë këtë situatë dhe si mundet një zyrtar i lartë që ta bëjë një vlerësim të një kapitali të caktuar. Asnjëherë nuk kemi gjet mbështetje sepse as Ministria e Drejtësisë nuk ka një vizion të qartë për këtë çështje për shkak se janë shumë faktor që duhet me qenë të lidhur në një aspekt, të janë zinxhirë për shkak të vlerësimit. Mirëpo, unë konsideroj që është e rëndësishme për publikun dhe për agjencinë që kapitali apo asetet të jenë të paktën të deklaruar. Çdo gjë që është e deklaruar, është më e lehtë për t'u vlerësuar ose nëpërmjet institucioneve të pavarura ose të agjencive të specializuara. E rëndësishme është që asetet të jenë të deklaruar dhe të jenë publike për publikun. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit Frashër! Dikush tjetër? Pourdhëro,

ENIS SADIKU, zyrtar i lartë për mbikëqyrjen e pasurisë dhe dhuratave brenda Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Desha me u lidhë të çështja e parë apo të çështja e emërimit nga propozimet që i kemi propozuar na si agjenci edhe fjalën e zëvendësministrit ku tha se nuk mundemi me bë ndryshim të çështja e emërimit të projektligjin, fjala të prejardhja, por si pyetje nëse shtohet, pse nuk mund të bëjmë më ndryshime.

BEHAR SELIMI: Faleminderit!

Sipas Rregullores ne mund të ndërhyjmë në projektligjin, mund të bëjmë amendamente në projektligjin që na ka ardhur, na nuk mund të dalim jashtë saj.

Ndërhyrje: Po Behar po është titulli i Projektligjit që të ishin anëtarë, këtu po thotë, këtë mundemi me e ndryshuar nëse nuk përshtatet me

BEHAR SELIMI: jo, jo sepse projektligji është në ligj, do me thënë se nuk ka...

Ndërhyrje: e ato që e konsideron, a është e arsyeshme apo jo mund me punuar, na vendosim çka është e arsyeshme...

BEHAR SELIMI: Po, po teknika legislative, jo por është edhe një çështje nuk e di pse ka domethënie të madhe kjo sepse, nëse e shihni amendamentimin, e shihni se Agjencisë Anti-Korrupsion i rritet autoriteti në fushën e procedurave parapenale, domethënë sidomos përmes kontrollit të plotë dhe kontrolli i plotë ka mundësi bile, bile në mënyrë të heshtur te kontrolli i plotë para provës nganjëherë bie ani pse akoma nuk jemi në procedurë, po bie te zyrtari i cili ka deklaruar pasurinë në mënyrë të rrejshme kur ju shkoni dhe doni me verifikua formularët e raportimit të pasurive, shprehimisht thuhet ... ai duhet të na shpjegoj prejardhjen dhe në momentin që thuhet: ai duhet të na shpjegoj prejardhjen, veç bara provës parimisht dhe kushtimisht po flas kalon atje prandaj nuk e di tash për tash sa kishte me na ndihmuar shumë kjo, por sidoqoftë faleminderit që e ngrite këtë çështje, sipas rregullores, do me thënë kështu është një interpretim. Na ndërkohë nëse gjejmë një interpretim tjetër që na ndihmon dikush që është më kompetent në fushën e interpretimit të rregullores, ne edhe mund ta ndryshojmë se nuk ka, unë personalisht edhe si jurist nuk po shoh ndonjë domethënie të madhe këtu por në përgjithësi personalisht mendoj që ndryshimet që janë bërë, janë si pasoj e ndryshimeve të kodit të procedurës dhe të kodit penal, por sponzoruesi ka dal pak përtej kësaj mendoj unë dhe është për t'u vlerësuar, e keni sidomos kontrollin e plotë, e keni po ashtu edhe kontrollin e plotë me short 20% që është një mekanizëm shumë interesant, por që gjithsesi ndikon në parandalim të korrupsionit për shkak të mosdeklarimit të pasurisë. Pra rritja e numrit të anëtarëve, bile me ju thënë të drejtën këtu jemi në vi me liritë dhe të drejtat e njeriut dhe goxha në rrezik, jemi si në kufi, sepse kemi futur shumë aty, bashollët, vëllezërit e motrat, e tjerë, e tjerë. Domethënë kjo nuk është bash, bash, por megjithatë jemi këmbëngulës dhe nuk prishë punë me zgjeruar akoma më shumë të gjithë ata që ne mendojmë se zyrtarët përpiqen me fshehtë apo me shpërndarë pasurinë, e që ne pikërisht atë po e synojmë.

Sipas amendamentimit këtu, që i është bërë Ligjit, ne si Grup punues do të përpiqemi me i marrë parasysh këto që i thatë e që lidhen me nenet përkatëse këtu, në bazë të Rregullores këtu mund të ndërhyjmë.

Pati gjatë shpjegimeve dhe dëgjova se ka mundësi diku me shtuar paragrafe e tjerë, e tjerë, neve nuk na pengon absolutisht. Bile Komisioni për ligje ka

qenë shumë i afër dhe kemi pasur bashkëpunim edhe me Ministrinë e Drejtësisë – sponzoruesin në shumicën e kodeve të procedurave po është krejt aspekti i teknikës ligjore, nuk ka asgjë të keqe.

Por, përfundimisht, po mendoj unë, edhe duke qenë se i njoh pak a shumë ligjet në këtë fushë dhe në rajon dhe jam i detyruar, për shkak se i takoj Komisionit të ligjeve, është ligj i krahasueshëm, bile është ligj shumë i avancuar dhe sa i përket dukurisë së deklarimit të pasurisë po edhe dukurive tjera që në një mënyrë e stimulojnë korrupsionin, legjislacion më të avancuar nuk ka. Në të vërtetë nuk ka as në Evropën Juglindore me të cilët do të duhej me u krahasuar me legjislacion, e le më në Evropën Perëndimore që e kemi vështirë të krahasohemi, po as në Evropën Perëndimore nuk ka, mosdeklarim të pasurisë si vepër penale, dhe po ashtu është siç tha zonja Haxhiu, unë kam qenë kryetar i Grupit dhe e di që ne në Komision e kemi futur atë dhe propozimi ka ardhur edhe nga shoqëria civile dhe ne jemi kanë të gatshëm.

Është i avancuar shumë. Problemi është te zbatimi. Po ju them shumë sinqerisht edhe si ish polic nuk ka asnjë dispozitë ligjore që e pengon një hetues apo një prokuror që t'i hetojë zërat se dikush ka pasuri marramendëse. Është veprimtaria para penale, procedura para penale, mundet me i pyet kojshitet kah i erdhi pasuria, e tjerë, e tjerë e me ardhur deri te një diçka që quhet pastaj bazë ligjore për të filluar mekanizmat tjerë, por nuk ka vullnet te prokurorët tanë me luftua dukuri të tilla. Dhe, disa janë frikacakë disa nuk donë me pas telashe dhe ne kemi problem sepse nuk po mundet në sistemin tonë të drejtësisë, është problem me ndërhy dikush e me vetë pse s'po punoni. Mekanizmat politikë s'bën hiq e hiq, po pastaj edhe ke problem, sepse është një këshill prokuroria atje, edhe ju e dini si agjenci i keni, sa kallëzime penale i çoni, ata thonë jemi duke i shqyrtuar e tjerë. Problemi pra është te Këshilli Prokurorial në këtë vend dhe te Këshilli Gjyqësor.

Dhe, në anën tjetër, nuk kemi një sistem përmes të cilit ne i mbajmë përgjegjës ata. Kështu që, mendoj se është një avancim i infrastrukturës ligjore. Ne si Grup punues do të përpiqemi, kishte me qenë mirë, sidomos agjencia, e di që keni edhe kompetencë juridike dhe njerëz që dinë me bë amendamente, na e lehtësoni teknikisht, që ne me i marrë ato amendamente në këto nene.

Tash për tash kështu është. Nëse ne e marrim një përgjigje nga dikush që është më kompetent në fushën e ndonjë zyre e tjerë, e ndryshojmë edhe emrin se nuk prishë punë. Po nuk po shoh pasoja, nuk po shoh implikime juridike prandaj unë ju falënderoj shumë. Nëse dikush dëshiron të kyçet...? Po, Albulena!

ALBULENA HAXHIU: Po më intereson me e ditur se qysh funksionon 20% i deklarimeve të pasurisë. Nuk e kam has më herët këtë paragraf, kështu që qysh funksionon kjo dhe ndoshta pyetja i shkon edhe agjencisë. Shorti! Do me thënë qysh funksionon ajo.

(Ndërprerje e incizimit)

ALBULENA HAXHIU: Po e lexoj! Neni 9, paragrafi 6: Kontrollit të plotë çdo vit i nënshtrohen të paktën 20% e formularëve. Përzgjedhja e deklaratave që i nënshtrohen kontrollit të plotë, bëhet me short.

Qysh funksionon kjo?

Ndërhyrje: OK! Një orientim rreth kësaj, se si tash do të funksionoj, se ka funksionuar ndryshe, do të thotë kontrolli i plotë, 20% është përzgjedhur vet brenda Agjencisë, do të thotë që ne e kemi paraparë çka të kontrollojmë.

(Ndërhyrje)

E, po! Me rregullore në fakt. Ndërsa ky është marrë një model, do të thotë prej shtetit shqiptar, atje e kanë një model të tillë dhe ka qenë shumë efikas. Domethënë të gjithë zyrtarëve që kanë pasur për deklarimin e pasurisë i është caktuar nga një numër, për shembull prej 01, 02, 03.... deri në 4000. Është si lloj loto, si lloj shorti dhe kanë qenë të gjitha mediat, OJQ-ët dhe të gjitha ato dhe e kanë tërhequr nga një numër dhe është bërë numri, për shembull, prej 200 personave dhe ata numra janë kthyer në emra, kush ka qenë, cili numër ka qenë i tillë dhe me ta është marrë, domethënë gjatë një periudhe të caktuar.

(Ndërhyrje)

Jo, kjo është mediale, ndoshta.

(Ndërhyrje)

Ne gjithmonë e kemi bërë, se e kemi pasur me ligj. 20% gjithmonë Agjencia i ka tejkaluar, do të thotë këtë.

(Ndërhyrje)

Tash, janë persona të caktuar.

(Ndërhyrje)

Po, është një plus.

(Ndërprerje e incizimit)

Ndërhyrje: Më falni zëvendës...! Ndoshta ju e kryet. Unë kam marrë pjesë një herë në modelin e shtetit shqiptar, qysh e kanë. Është edhe inspektorati i deklaramentit të pasurisë, kjo çështje ka të bëjë me shumë me transparencën. Publiku ka të drejtë, gjatë momentit të tërheqjes së atij numri, në moment që dikush e ka fatin për t'iu nënshtruar një kontrolli detaj, një qytetar i thjeshtë, e drejta e tij për të nxjerrë atë numër ka me të një ministër ose një deputet, ose kryetari i vendit me të nënshtruar një kontrolli detaj të pasurisë.

Nuk ka të bëjë kjo me atë... se njerëzit... Pak është ndoshta konsiderohet 20%.

(Ndërhyrje)

Jo, nuk ka të bëjë. Kjo është diçka krejt tjetër.

(Ndërhyrje)

Kjo është vetëm për shkak të transparencës dhe publikut, qasja e publikut në kontrollë.

ALBULENA HAXHIU: Më falni që po ndërhyj, por sinqerisht është pak. Komplet, deri ku, çka është deklaruar, dhe vërtetohet në bazë të

institucioneve bankare në këtë rast në bashkëpunim me institucionet bankare apo qysh?

(Ndërprerje e incizimit)

Ndërhyrje: Unë po e shpjegoj pse është bërë si model, ndoshta edhe pse shteti shqiptar e ka bërë, sepse publiku ndoshta, grupet e interesit kanë shfaqur ndoshta njëfarë lloj dyshimi pse po bëhet vetëm për një deputet ose për 10 deputetë. Kjo ka të bëjë me publikun, për tu qartësuar se nuk është çështja vetëm te njerëzit e caktuar, por gjithsecilit që e nxjerr një numër të tillë, që është i vendosur numri me emër të një zyrtari ka me u bërë një hetim detal.

BEHAR SELIMI: Faleminderit shumë! Unë ju falëndero. Mendoj se këto do t'i marrim parasysh, dhe jo vetëm që mendoj, por si Grup punues do t'i marrim parasysh, veç prapë po them, nëse i keni... është mirë me i bërë në formë të amendamentit, që na e lehtësoni neve në këto që na kanë ardhur. Ne e shtojmë ndonjë paragraf a e heqim një paragraf, kurse.... Urdhëro, zëvendësministër!

ZËVENDESMINISTRI: Edhe agjencioni, edhe të gjitha kanë qenë pjesë e grupit. Eventualisht në grup që s'ka kaluar diçka, që do të thotë konsideroni se është e domosdoshme për të qenë ky ligj më komplet ose më i qartë apo më funksional, atëherë udha është e çelë.

Përndryshe, unë besoj se në kuptim të prejardhjes, të kontrollit tjetër është vlerësimi i pasurisë së atyre, do të thotë, që është shumë delikate ose edhe agjencion me kanë në nivel të Kosovës do të ishte problem i madh, se ju e dini, një pronë prej këtu dallon me megjë, qysh themi ne. Dhe tash unë jam detyruar pronën time me e deklaruar qysh e kam vlerësuar vet. Domethënë, pasuria e babës, toka kaq hektarë, i bën qëkaq. Kam harrue para dhjetë vjetëve sa, veç duhet me këqyrë, se përndryshe atëherë ka qenë një vlerë tjetër, një mendim dhe perceptim i imi, e tash është diçka tjetër. Mund të jetë edhe ndryshe. Domethënë, me rëndësi është ajo pronë me qenë e regjistruar, qysh u tha, dhe me qenë e deklaruar e pastaj kontrolli, e tjera, e tjera, është çështje tjetër.

BEHAR SELIMI: Faleminderit shumë zëvendësministër! Faleminderit edhe për këto bllokat që na i dhatë, po me gjuhën juridike tuajën, qysh quhet kjo që po na e jepni bash sot në dëgjim publik?

(Ndërhyrje)

Faleminderit! Urime festat e fundvitit! Faleminderit shumë! Do të jemi në kontakt për amendamentim konkret. Faleminderit shumë!

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë